



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 192, datë 07.05.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër si vijon:

1. Kërkesës nr. 124 prot., datë 17.03.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: I pandehur: {...}, i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, të parashikuar nga neni 323/1 i Kodit Penal;
2. Kërkesës nr. 160, prot., datë 08.04.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Viktimë akuzuese {...}, me të pandehura: {...}, dhe {...}, të akuzuara për kryerjen e veprës penale: “Dëmtime të tjera me dashje”, Dhunim banese” dhe “Fryerje”, të parashikuara nga nenet 90, 112 e 119 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështjen civile me Paditëse: {...}; E paditur: {...}; Objekti: Detyrim për dëmshpërblim page.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Neni 179/1, 190/1 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Flutura Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: {...}, {...}{...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, etj; Objekti: Kultivim i bimëve narkotike.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: Gjykimin e çështjes për veprën penale “Falsifikim i vulave, stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Neni 130/a/4 i Kodit Penal.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}, {...}; Objekti: Gjykimin e çështjes për veprat penale “Vjedhja e kryer në bashkëpunim”, “Përvetësim i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria penale”, parashikuar nga nenet 129, 134/2, 287/b të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. 65, viti 2020 në ngarkim të të pandehurit të mitur {...}, akuzuar për veprën penale “Prodhim e shitje narkotikësh”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Ermira Dedja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen civile me Paditëse: {...}; I Paditur: Shoqëria e Sigurimeve “Interalbania Vienna Insurance Group sh.a.”; Objekti: Shpërblim dëmi.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me kërkesën për gjykimin e të pandehurve {...}dhe {...}, akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh në bashkëpunim” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me kërkesën për gjykimin e të pandehurit {...}, akuzuar për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen civile me Padi të: {...}; E paditur: {...}, {...}; Ndërhyrës kryesorë: {...}, {...}, etj.; Objekti: Anulimi i vendimit të AKKP, etj.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr. 586 prot., datë 15.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Padi të: {...}, i paditur: {...}, {...} Tepelenë, objekti: “Anulim i vendimit të KKKP”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen civile me Padi të: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Ervin Sulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen civile me Padi të: {...}etj; I paditur: {...}etj; Objekti: Pjesëtim pasurie.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Arben Lera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: Vjedhje me dhunë, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Petrit Çomo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Të pandehur: {...}, {...}, {...}, etj; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 278/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal” (Dosja penale e ndarë nga dosja me të bashkëpandehur {...}, {...}, {...}si dhe e lidhru me dosjet penale me të pandehur, si dhe me dosjen penale me te pandehur Fisnik Sadiku).

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina (relator), gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ilir Përdeda dhe gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, etj. (dosje e ndarë nga dosja nr.21/127 regj, datë 26.09.2019 në ngarkim të të pandehurve {...} etj).

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj; I paditur: {...}, etj; Objekti: Detyrim njohje pronar.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...} etj; Akuza: Kultivim i bimëve narkotike, etj.
3. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Shpërdorim detyre.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues{...}; Me pjesëmarrjen e IEVP Korçë; Objekti: Ulje dënimi.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; me objekt: Ankim kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec datë 13.07.2020; Objekt shqyrtimi: Kërkesa për përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti: Kundërshtim vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal nr. 2159, datë 21.12.2019 me të pandehur {...}, përmbarues gjyqësor privat lidhur me kryerjen e veprave penale parashikuara nga nenet 248, 250, 251 të Kodit Penal.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 13.05.2020 të prokurores {...}, në lidhje me materialin kallëzues nr.175, datë 12.05.2020. Objekti i shqyrtimit: “Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit Dritan Hasani”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Rishikim vendimi.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}Tiranë, {...}; Person i tretë: {...} sh.p.k., Shoqëria tregtare “{...}” sh.p.k.; Objekti: Kundërshtim vendimi.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkesë: {...}; Objekti: Sigurim padie.
4. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Personi i tretë: Përmbartuesi privat gjyqësor {...}; Objekti: Kundërshtim i veprimeve përmbartimore.
5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkesë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Të pandehur: {...}; Akuzë: “Shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Pjesëmarrëse: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; Objekti: Ankim kundër vendimit nr. 936 prot., të pushimit të çështjes nr. 2577, datë 04.12.2020, procedim i regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyrë”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...} etj; Objekti: Pushim cenimi i pronësisë.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...} etj.; I paditur: {...}. Tiranë; Objekti: “Pagim dëmi”.
3. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}, etj; Objekti: Fitim i pronësisë me parashkrim fitues.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici (relatore), Izet Dushaj dhe Florjan Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj; I paditur: {...} Tiranë; Objekti: Shfuqizim vendimi.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...} etj; I paditur: {...} Tiranë etj; Objekt: Detyrim pagim page.
6. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuzë: Neni 134/2-22 i Kodit Penal.
7. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...} etj; Akuzë: Neni 283/2 e 273/3 të Kodit Penal.

8. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Ndaj shtetasve: {...}, {...}, {...}; Kallëzues: {...}; Objekti: Pushim procedimi penal.

9. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: Gentjan Ndoci; Akuza: Neni 139-25-22 të Kodit Penal.

10. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë ndaj shtetasit {...}; Objekti: Pushim gjykimi.

GJYKATA E APELIT TIRANË

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Palë e interesuar: {...}, {...}; Objekti: Kundërshtim vendimi të prokurorisë për "Pushimin e procedimit penal nr.3338, e vitit 2016".

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Refuzimin e shqyrtimit të kërkesës nr.104 prot., datë 12.03.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, për caktim gjyqtari, në çështjen administrative me paditës: {...}, {...}, {...}, Ervin Aliu, {...}, etj., e paditur: {...}, {...}, objekti: "Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e paditësve në pozicionin e punës "ndihmës ligjor", në masën 75% të pagës së gjyqtarit të Gj. Administrative të Apelit, etj."

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR